

Modul 2 & 3

Përse shërbejnë të dhënat në shkollë?

Dr Eralda Zhilla

Përse shërbejnë të dhënat?

Cilat janë qëllimet e shkollës tuaj në tre vitet e ardhshme?

Cilat të dhëna do ju ndihmonin të gjykonit nëse shkolla i ka përmbushur ose jo qëllimet e saj?

Si i përdorni të dhënat që keni mbledhur për të përmirësuar arritjet e nxënësve nga njëri vit në tjetrin?

Cilat mund të jenë disa të dhëna shtesë që mund ti mblidhni dhe pse?

Në çfarë mënyre përfshihen mësuesit, drejtuesit dhe komuniteti në mbledhjen dhe analizën e të dhënave?

Puna me të dhënat në shkollë



Përse shërbejnë të dhënat

- Të masim progresin e nxënësve
- Të sigurohemi që nxënësit kanë një strukturë që të mos dështojnë
- Të masim sa efektiv është programi që ne ofrojmë
- Të mbikqyrim zhvillimin hap pas hapi të shkollës
- Të përlllogarisim burimet e nevojshme
- Të llogarisim kostot që do kemi
- Të raportojmë për komunitetin
- Të përmbushin kërkesat e pushtetit qendror (qeveria)
- Të ruajmë fokusin në edukimin e brezit të ri.

Kur nuk shërbejnë më të dhënat?

- Nëse të dhënat që ne kemi mbledhur nuk janë të besueshme dhe të përshtatshme për kontekstin tonë.
- Nëse ne nuk kemi drejtuar pyetjet e duhura dhe kjo evidentohet pas analizës së të dhënave që kemi mbledhur.
- Nëse analiza e të dhënave nuk i shërben vendimeve në të mirë të shkollës, pra nuk ka qenë SMART.

• *Jo çdo gjë me të cilën përballemi mund të ndryshojë,
por asgjë nuk mund të ndryshojë nëse ne nuk përballemi me të.*

• — James Baldwin

Nga ta nisim????

- Të nisim me informacionin bazë që ne kemi.
- Të kemi një qëllim në mendjen tonë, ndryshe dështojmë.
- Të përcaktojmë më parë çfarë duam të dimë.
- Të ndërtojmë pyetje specifike në funksion të qëllimit.

• *Çfarë?*

Pse?

Si?

Masim performancën e nxënësve

- Sondazhe – pyetësor
- Intervista të strukturuar, gjysëm të strukturuar, të pastrukturuar.
- Fokus grup
- Ditari i mësueve
- Vëzhgimi në klasë.
- Vlerësime të tjera si: detyra, projekte, dosje pune, portofole të nxënësve.
- Teste në fillim dhe në fund të vitit shkollor, tremujorit etj.

**Ju mund të keni projekt propozimin më të mirë në botë,
por nëse nuk arrini të mblidhni të dhënat që kërkon,
projekti juaj nuk quhet i përfunduar.**

Kategoritë kryesore të të dhënave

- Të dhënat grupohen në dy kategori kryesore:
 1. Të dhëna cilësore
 2. Të dhëna sasiore.

Të dhënat cilësore

- Janë jonumerike
- Në të shumtën e rasteve përshkruese.
- Të dhënat që mblidhen janë në formën e fjalëve ose fjalive.
- Shpesh (jo gjithmonë) këto të dhënat masin ndjenja, emocione ose perceptime subjektive nga ana e subjekteve.
- Përpiqen ti përgjigjen pyetjes “si” dhe “pse”
- Përdorin metoda të pastrukturuara.
- Shërbejnë për të eksploruar më tej.
- Përdorin kryesisht pyetje me fund të hapur.
- Janë të shtrenjta dhe kërkojnë shumë kohë në implementim.
- Të dhënat nuk mund të përgjithësohen për një grup më të madh individësh.

-
- Disa nga metodat kryesore që përdoren në të dhënat cilësore, janë:

Intervistat

Vëzhgimet

Fokus – grupet

Shqyrtim i dok ekzistuese.

Ne përdorim shënime që mbajmë, skedula të ndryshme, regjistrim në audio, foto dhe lloje të tjera dokumentacioni të nevojshëm.

Të dhënat sasiore

- Përdorin të dhëna numerike
- Mund të përlogariten në programe kompjuterike
- Përdorin shkallë të ndryshme matëse
- Shpesh (jo gjithmonë) shërbejnë për të matur dicka.
- Nuk kanë shumë kosto
- Kërkojnë pak kohë në administrim
- Kanë si qëllim të mbledhin, krahasojnë dhe përgjithësojnë të dhënat.

-
- Disa nga metodat kryesore që përdoren në të dhënat sasiore, janë:

Vëshgimi dhe regjistrimi i ngjarjeve shumë specifike (psh nr i prindërve qe kërkojnë të takojnë drejtorin në një moment të caktuar gjatë ditës)

Përfitimi i të dhënave të nevojshme nga programet kompjuterike

Pyetësor me pyetje të mbyllura. (me vetëadministrim ose nga intervistues në terren)

Strategjitë e të pyeturit

a. Strategji filtruese

Kjo strategji shërben për të matur nivelin e njohurive të respondentëve. Psh:

- Intervistuesi: Keni njohuri për modifikimet e fundit në standarde?
- Respondenti: Po, kam
- Intervistuesi: Ku konsistojnë këto modifikime?

b. Strategji përsëritëse

Kjo lloj strategjie përdoret për të matur dhe vlerësuar qëndrueshmërinë e respondentit lidhur me një çështje të caktuar

- E kontrolloni punën e fëmijëve tuaj në internet?
- I keni dhënë liri të plotë fëmijëve për të punuar në internet?

Pyetja e dytë duhet formuluar në tjetër mënyrë, por të ruajë të njëjtin fokus.

c. Strategji zinxhir

1a. Gjatë muajit të fundit, keni marrë pjesë në ndonjë aktivitet jashtë shkolle? Po _____ Jo _____

1b. Në çfarë aktiviteti specifikisht?

Sport _____ Teatër _____ Argëtues _____

Shkallet e matjes

Shkallët Emërore (Nominale)

Shkallët e Radhitjes (Ordinale)

Shkallët Intervalore

Shkallët e raportit (Ratio)

Shkallet Emerore

**Fokusohen ne klasifikimin e ngjarjeve
permes numrave, per te dalluar nje grup
nga nje tjeter**

Shembull

Ju lutem percaktoni gjendjen tuaj civile.

Martuar Beqar Divorcuar

Shkallet e Radhitjes

E lejojnë personin të rendis situata a faktorë në mënyrë relative

Shembull.

Listoni nga niveli 1 ne nivelin 10, situatat qe ju shkaktojne me shume ankth, ku 10 eshte situata me pak ankthndjellese dhe 1 eshte ajo qe ju shqeteson me shume.

1.

2.

...

10.

Shkallet Intervalore

Tregojnë vlerën absolute midis cdo pike të shkallës

Shembull

Sa mundesi ka qe ju t'i rekomandoni nje miku te vazhdoje studimet në shkollën tonë?

Aspak

Plotësisht

1

2

3

4

5

6

7

Shkallet e Raportit

Lejojnë identifikimin e diferencave absolute midis çdo pike të shkallës, si dhe krahasime absolute midis përgjigjeve.

Shembull.

Rrethoni numrin e fëmijëve nen 18 vjec që jetojnë në shtëpinë tuaj.

0 1 2 3 4 5 6 7 (Nese me shume se 7, specifikoni sa ____.)